REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 99/17
Datë/Datum 24.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 99/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej z. Ekrem Salihu - Kryetar, z.Tefik Sylejmani – Referues dhe z.Goran Milenkoviq – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **"Comando"shpk & "Security Code"shpk- Prizren**, me nr. 99/17, kundër AK – Komuna Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve shendetesore"**, me nr. prok:**622/17/302/221**, në seancën e dt. **24.05.2017**, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , ankesa e OE, **"Comando"shpk & "Security Code"shpk- Prizren**, me nr. **99/17**, e parashtruar kundër AK – Komuna Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve shendetesore"**, me nr. prok:**622/17/302/221**, si e bazuar.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues / Komuna Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve shendetesore"**, me nr. prok:**622/17/302/221**, si i pa bazuar.

III. **Obligohet,** autoriteti kontraktues / Komuna Prizren, qe proceduren e prokurimit me titull: **"Sigurimi fizik i objekteve shendetesore"**, me nr. prok:**622/17/302/221**, ta kthej ne **Ri-vleresim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

VI. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues **"Comando"shpk & "Security Code"shpk- Prizren** janë te bazuara, konform nenit 118 të LPP-së i bëhet kthimmi i sigurimit të ankeses, megjithatë i njejtit OE, obligohen që në periudhën kohore prejë më së largu gjashtëdhjetë (60) diteve, të parashtrojnë kërkesë për tërheqje të mjeteve, në të kundërtën mjetet do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues – Komuna Prizren, më datën: 20.02.2017, ka publikuar njoftim për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Sigurimi fizik i objekteve shendetesore",** me nr. prok:**622/17/302/221**.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjëshëm me çmim më të ulët.

Kundër njoftimit për dhënje të kontratës, operatori ekonomik, **"Comando"shpk & "Security Code"shpk- Prizren,** në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankes në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesave, në bazë të nenit 113.1, të LPP-ës nr.04/L-042, më datën.13.04.2017, ka autorizuar ekspertët e OSHP-së, për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertëti e OSHP-së, -z.Qazim Hoxha dhe Visar Bibaj më datën. 24.04.2017, i dorëzojnë Panelit Shqyrtues , raportin e ekspertizës , ku në raportin e tyre kane shqyrtuar – trajtuar pretendimet ankimore te perfshira ne ankese, njëkohësisht kane rekomanduar propozuar qe lenda te kthehet ne ri-vleresim ndersa ankesa te aprovohet si e bazuar.

Autoriteti kontraktues / Komuna Prizren, përmes parashtresës me shkrim të dt. 24.04.2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 24.04.2017, ndersa OE ankues nuk eshte prononcuar.

Gjatë seances se shqyrtimit te dates 24.05.2017, e cila u mbajt pa prezencen e paleve konform nenit 26, paragrafi 1, te rregullores se punese se OSHP-se, ku ishin prezent anetaret e panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lendes

duke e bere kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit, rrjedhimisht paneli shqyrues konstatoi se pretendimet ankimroe te parashtruesit te ankeses jane te qendrueshme per faktin se OE, i rekomanduar per dhenje te kontrates si dhe OE, i renditur i dyti per nga cmimi i kualifikuar si i pergjegjeshem por i pa sukseseshem nuk i mbulojne kerkesat e dosjes se tenderit dhe njofimit per kontrate, gjegjesisht "sipas shkresës zyrtare të ARBK të datës 04.04.2017 del se bizneset "SFK" shpk dhe NTSH "SFK" janë 2 biznese aktive paralelisht, të ndryshme për nga statusi, me numra të ndryshëm biznesi e numra të ndryshëm fiskalë, pra me subjektivitet juridik plotësisht të pavarur, rrjedhimishte sipas dispozitave ligjore te LPP-se, oferten e tyre e bene te pa pergjegjeshme.

Poashtu paneli shqyrtues konstaton se kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të listuara në pozicionet 8.1 e 8.2 të FDT, ku është kërkuar që të sillen pasqyrat financiare të kompanisë të shoqëruara me qarkullimin financiar nga bankat në vlerë prej 90 000 euro për tri vitet e fundit 2014-2016 ose deklaratat vjetore të tatimeve të dorëzuara në ATK, deshmite e ofruara dokumente janë te përziera të të 2 operatorëve te larte permendur. Pasqyra Financiare dhe qarkullimi i nxjerrë nga Procredit Bank arrin në 26 832.76 euro, pra nuk e përmbush kërkesën prej 90 000 euro sa është kërkuar për atë periudhë.

Poashtu ofertën e dytë më te lirë OE. "Rosa Security" shpk, ka prezentuar dokumentacion në emër të 2 subjekteve me identitet e subjektivitet të ndryshëm, rrjehimisht ky operator ka ofruar vetëm 2 kontrata të përfunduara në vlerë prej 19 300 euro, rrjedhimishte nuk janë përmbush në tërësi kërkesat e publikuara me DT, ngase vlera e kërkuar ka qenë 65000 euro. Poashtu ky OE, nuk ka ofruar dëshmitë e plota dokumentare mbi qarkullimin financiar, ku në vend që të ofrohen pasqyrat financiare të shoqëruara me deklaratat tatimore vjetore të ATK-s,ka ofruar qarkullim bankar i lëshuar nga bankat, gjë që paraqet mos plotësimit të kërkesës së publikuar ne FDT.
Andaj nga t
Andaj nga të cekurat më lartë rezulton se autoriteti kontraktues me rastin e njoftimit për dhënie të kontratës nuk ka respektuar nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE :
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për çështje
Administrative për kompensim dëmi në afat prej
30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – Ankuesit
1x1 ekzemplar - Autoritetit Kontraktues
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu